

VENDIM  
Nr. 64/2024

PËR RRËZIMIN E LISTËS SË DYTË NË BLOK TË KANDIDATËVE TË  
PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË  
NGA RADHËT E AVOKATËVE SIPAS LIGJIT NR. 115/2016, "PËR ORGANET E  
QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe nenit 55 të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së dytë në blok të kandidatëve për anëtarë nga radhët e avokatëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

- Artan Reçi
- Bledar Bajri

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 4.7.2024.